

# EPOKA

## ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7121  
E martë, 20 shkurt 2024  
Çmimi 0.50

Haxhiu në Zagreb flet  
për reformat në  
sistemin e drejtësisë

I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



## SARRAZIN: KOSOVA DHE SERBIA DUHET TA ÇOJNË PËRPARA ZBATIMIN E OHRIT

I FAQE 4-5



I ngarkuari i Qeverisë së Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka theksuar se Kosova dhe Serbia duhet ta çojnë përpara zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. Kjo,

sipas tij, është vendimtare për të dyja vendet. "Më duket se nuk ka kuptim të mendosh shumë se çfarë do të vijë paskëtaj. Ne jemi për Ohrin dhe duam që të dyja palët ta çojnë përpara zbatimin e

Ohrit dhe mendoj se kjo është vendimtare. Unë shoh në të dyja palët se politika e brendshme do të bëhet një faktor i rëndësishëm", ka deklaruar Sarrazin

KURTI:  
ME SHBA-në  
S'PAJTOHEMI  
PËR GJITHÇKA,  
POR RAPORTET  
JANË TË  
MIRA



TELEKOMI I KOSOVËS BËN THIRRJE PËR VEPRIME URGJENTE PËR PARANDALIM TË KRIMIT FINANCIAR



**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni Xheqisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
Fax: +389 44 487 755 Mob: +377 44 501289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

Endrit Shaqiri  
+38344685122

**INFINITY**  
Digital Agency  
Internet Website,  
Marketing...

AKTUALE  
URSULA VON DER LEYEN  
SYNON NJË MANDAT TË DYTË  
TË SHEFES SË KE-SË

PROTESTË NË SHKUP:  
NAVALNY, VIKTIMË E REGJIMIT  
GJENOCIDAL TË PUTINIT

PAS THACIT, EDHE REXHEP SELIMIT I  
LARGOHËT NJË PREJ AVOKATËVE MË  
TË RËNDËSISHËM

EKONOMI



OSMANI: JANË DUKE VAZHDUAR  
DISKUTIMET PËR PLANIN  
E TRANZICIONIT TË ZBATIMIT  
TË RREGULLORES SË BQK-SË

MINISTRJA RIZVANOLLI VIZITON  
NDËRMARRJEN KRU "DRINI I  
BARDHË", KËRKON ANGAZHIM  
NË PUNË

SPORT



BASKETBOLLISTËT E KOSOVËS PO  
STËRVITEN INTENSIVISHT PËR  
NDESHJEN NDAJ IRLANDËS

## Ursula von der Leyen synon një mandat të dytë të shefes së KE-së

**BERLIN, 19 SHKURT** - Ursula von der Leyen do të synojë që të fitojë një mandat të dytë si shefe e Komisionit Evropian. Nëse e fiton, ajo do të mund të bëhet ndër politikanët më të rëndësishëm që përfaqëson bllokun evropian me 450 milionë banorë brenda një gjeneratë. "Po e marrë këtë vendim me vetëdije të plotë dhe të menduar mirë. Dua të garoj për një mandat të dytë në pozitë dhe jam e lumbur që partia më ka nominuar sot", ka thënë von der Leyen në një konferencë përmes pas takimit të Partisë

Demokristiane në Berlin. Pas pesë vjetësh në krye të bllokut me 27 anëtarë dhe përballjes me shumë sfida, përfshirë pandeminë e koronavirusit dhe dy vjetët e para të luftës së Rusisë në Ukrainë, emri i 65-vjeçaresë është shtyrë përparrë nga partia e saj gjermane Unioni Demokristian, dhe kjo gjë do të zyrtarizohet kur një grup partiak në nivel evropian të mblidhet në Bukuresht muajin e ardhshëm. Presidenti i partisë, Friedrich Merz, ka thënë të hënën se partia e tij e ka zgjedhur në

mënyrë unanime von der Leyenin që të jetë kandidata për të fituar sërisht atë pozitë. Në Konferencën e Sigurisë, që është mbajtur gjatë fundjavës në Munih, von der Leyen ka thënë se BE-ja do të paraqesë një plan për strategji të re në mbrojtje, që synon t'i lehtësoj procedurat e blerjes së armatimit mes vendeve të bllokut. Liderët e 27 vendave anëtarë të BE-së do ta zgjedhin presidentin e Komisionit pas zgjedhjeve që do të mbahen në Parlamentin Evropian në muajin qershor.



## BE-ja nis një hetim zyrtar kundër 'TikTok'-ut, e akuzon për dështim në mbrojtjen e të miturve

**BRUCEL, 19 SHKURT** - Brukseli ka njoftuar të hënën për një hetim që synon platformën e medieve sociale "TikTok" për dështimet në mbrojtjen e të miturve, i dyti i këtij lloji sipas rregulloreve të reja evropiane pas platformës "X" (ish-Twitter), e cila u hap në dhjetor. Komisioni Evropian shpjegoi se



ka filluar "një procedurë zyrtare" për të vendosur nëse "TikTok", në pronësi të grupit kinez "Byte Dance", ka shkelur "Aktin e

Shërbimeve Digitale (DSA) për të miturit", "transparencën e reklamave", "qasjen në të dhëna për studiuesit", si dhe "risqet që lidhen me faktin se (platforma 'TikTok' në fjalë) është projektuar në një mënyrë që të krijojë varësi" dhe "përbajtje të dëmshme". "Si një platformë që arrin miliona fëmijë dhe të rinj, 'TikTok' ka një

rol të veçantë për të luajtur në mbrojtjen e të miturve në internet, i cili është një nga priorititetet e mëdha të DSA-s", tha komisionari Evropian i Tregut të Brendshëm, Thierry Breton. "Kjo 'procedurë e shkeljes' pritet ta lejojë Komisionin Evropian të sigurojë që 'TikTok'-u t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm

"për ta mbajtur mirëqenien fizike dhe emocionale të të rinjve evropianë", shpjegoi ai. DSA hyri në fuqi të plotë të shtunën dhe detyrimet që ajo ofron tashmë po vendosen në të gjitha platformat në internet, nën kërcënimin e gjabave, për t'i mbrojtur më mirë përdoruesit nga përbajtja e paligjshme.

## Protestë në Shkup: Navalny, viktimi e regjimit gjenocidal të Putinit

**SHKUP, 19 SHKURT** - "Aleksei Navalny, lideri i luftës për demokraci dhe të drejtat e njeriut jetojnë në zemrat dhe mendjet e njerëzve liridashës në mbarë botën, si dhe në Federatën Ruse".

Xhabir Deralla, drejtuesi i organizatës "CIVIL", ka thënë se për vdekjen e Navalnyt përgjegjës është shteti rus. "Ne u bëjmë thirrje urgjentisht autoritetevë ruse të lejojnë një hetim të pavarrur mbi rrëthanat e vdekjes së Aleksei Navalny. Ne u bashkohemi kërkeseve përlirimë e të gjithë të burgosurve politikë në Rusi si dhe t'i jepet fund brutalitetit policor dhe shtypjes ndaj qytetarëve", ka thënë Deralla. Sipas tij, "regjimi rus duhet t'i japë fund luftës gjenocidale kundër Ukrainës"

e palodhshme për demokraci dhe të drejtat e njeriut jetojnë në zemrat dhe mendjet e njerëzve liridashës në mbarë botën, si dhe në Federatën Ruse".

Xhabir Deralla, drejtuesi i organizatës "CIVIL", ka thënë se për vdekjen e Navalnyt përgjegjës është shteti rus. "Ne u bëjmë thirrje urgjentisht autoritetevë ruse të lejojnë një hetim të pavarrur mbi rrëthanat e vdekjes së Aleksei Navalny. Ne u bashkohemi kërkeseve përlirimë e të gjithë të burgosurve politikë në Rusi si dhe t'i jepet fund brutalitetit policor dhe shtypjes ndaj qytetarëve", ka thënë Deralla. Sipas tij, "regjimi rus duhet t'i japë fund luftës gjenocidale kundër Ukrainës"



dhe ka kërkuar nxjerrjen e presidentit rus, Vladimir Putin, para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për t'u gjykuar për krimet e bëra. Vdekja e Aleksei Navalnyt ka

shkaktuar reagimin e zyrtarëve më të lartë shtetërorë në Maqedoninë e Veriut. Presidenti i Maqedonisë, Stevo Pendarovski, ka thënë se vdekja e liderit opozitar rus paraqet "ditë

të trishtë për demokracinë". "Jam i tmerruar nga vdekja e politikanit rus Alexei Navalny. Një ditë e trishtuar për demokracinë. Njerëzimi ka humbur një aktivist të patundur për të drejtat e njeriut", është thënë në reagimin e Pendarovskit, pas njoftimit përvdekjen në burg të liderit opozitar rus.

Vdekja e Navalnyt ka shkaktuar zemërim në gjithë botën, ndërsa Perëndimi e ka akuzuar shtetin rus në krye me Putinin përvrasjen e tij.

Autoritetet ruse janë duke refuzuar ta dorëzojnë trupin e Navalnyt te familja e tij, me arsyetimin se ende nuk kanë përfunduar hetimet.

## BE-ja zotohet se do ta mbajë Putinin përgjegjës përvdekjen e Navalnyt

**BRUCEL, 19 SHKURT** - Shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, u zotua se presidenti rus Vladimir Putin do të mbahet përgjegjës përvdekjen e udhëheqësit rus të opozitës, Alexei Navalny. Ai i bëri komentet pas një takimi që

zhvilloi në Bruksel me të venë e tij, Yulia Navalnaya. Vdekja e Navalnyt në një burg të Arktikut javën e kaluar e tronditi opozitën në miërgim të Rusisë, e cila, ashtu sikurse Perëndimi, drejtoi gishtin e fajit nga Kremlini. "Ne i shprehëm ngushëllimet më të thella të

BE-së Yulia Navalnaya. Vladimir Putin dhe regjimi i tij do të mbajnë përgjegjësi përvdekjen e Alexei Navalnyt", shkroi Borrelli në platformën X. "Siç e tha edhe Yulia, Putini nuk është Rusi. Rusia nuk është Putin. Ne do ta vazhdojmë mbështetjen tonë për

shoqërinë civile të Rusisë dhe mediet e pavarura", shtoi ai. Navalnaya iu drejtua ministrave të Jashtëm të BE-së në Bruksel, pasi u zotua se do ta vazhdojë luftën e burrit të saj kundër kontrollit të vrazhdë të Putinit mbi Rusinë. Ministrat e BE-së diskutuan



opsionet për t'i shkaktuar kostojtë reja Kremlinit pas vdekjes së Navalnyt.

# Haxhiu në Zagreb flet për reformat në sistemin e drejtësisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Në Zagreb të Kroacisë po mbahet konferenca "E ardhmja e zgjerimit të Bashkimit Evropian: gjyqësori dhe të drejtat themelore", organizuar nga Ministria e Drejtësisë e Kroacisë në bashkëpunim me Komisionin Evropian.

E pranishme në këtë konferencë ishte edhe ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila para ministrave të Ballkanit Perëndimor si dhe atyre nga Ukraina, Turqia, Gjeorgjia dhe Moldavia, përfaqësuesve nga BEJA, ka rikonfirmuar përkushtimin e Qeverisë e Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efikas dhe profesional. "Theksova se në rrugën reformuese Republika e Kosovës tashmë ka



filluar të shënojë rezultate në sundimin e ligjit, lufthan kundër korrupsionit, reformën penale

dhe civile, si dhe rezultate konkrete në adresimin e të drejtave të njeriut. Në veçanti

adresova faktin se përpjekjet tona synojnë garantimin e pavarësise, llogaridhënie, integrititetit, cilësisë

dhe efikasitetit të sektorit të drejtësisë në vendin tonë", ka thënë Haxhiu.

Ajo në këtë konferencë ka përmendur të gjitha reformat që ka ndërmarrë qeveria që nga fillimi i mandatit. "E progresin e arritur me theks ato që ndërlidhen me vetingun në sistemin e drejtësisë, pakon ligjore kundër krimit të organizuar dhe korrupsionin, adresimin e krimeve të luftës dhe veprimet që kemi ndërmarrë me qëllim të adresimit të dhunës në familje dhe me bazë gjinore", ka dekluaruar Haxhiu.

Ajo i ka njoftuar të pranishmit se Ministria e Drejtësisë ka pasur gjithsej 35 masa dhe detyrime që dalin nga PKZMSA dhe se nga këto detyrime, 28 masa janë zbatuar plotësisht dhe se për 7 detyrimet e tjera, po punohet intensivisht drejt finalizimit dhe realizimit të tyre.

## Studentët e Fakultetit Juridik të UP-së dalin të parët në garën rajonale në Podgoricë



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Ekipi i Fakultetit Juridik i Universitetit të Prishtinës, pjesëmarrës në garën Willem C. Vis International Commercial Arbitration Moot, ka fituar vendin e parë në para-garën rajonale të mbajtur në Podgoricë. Po ashtu, studentja e ekipit, Morea Pula, ka fituar titullin e folëses më të mirë të garës.

Para-gara e mbajtur në Podgoricë ka për qëllim përgatitjen e ekipave për garën kryesore, e cila do të mbahet në Vjenë në muajin mars 2024. Kjo para-garë është një ndër para-garat më të rëndësishme rajonale, e cila përbëhet nga ekipi të universiteteve më prestigjioze rajonale dhe evropiane.

Suksesi maksimal i studentëve të UP-së në këtë para-garë paraqet një hap të rëndësishëm drejt përgatitjes së ekipit për pjesëmarrje në garën kryesore. Ekipi fitues i Fakultetit Juridik të UP-së përbëhet nga: Ariana Rexha, Dea Fetiu, Melisë Sejdiu, Morea Pula, Nol Musa dhe Rea Hadri. Ndërkohë, trajnerët e ekipit janë

prof. ass. Donikë Qerimi, Ilir Hajraj dhe Art Sylaj. Gara VIS Moot është në mesin e garave që tanë janë pjesë e programit të përhershëm të Fakultetit Juridik, pas akreditimit të programit të reformuar, ku studentët marrin kredi/ECTS dhe financohen nga buxheti i fakultetit, UP dhe nga partnerët.

Pjesëmarrja e studentëve edhe në këtë rast është mundësuar nga fakulteti, UP dhe partnerët, e për çka UP falenderon në mënyrë të veçantë Departamentin Amerikan të Shtetit, Programin për Zhvillimin e të Drejtës Kontraktore (Contract Law Development Programme), për mbështetjen e ofruar për pjesëmarrjen në këtë para-garë.

Fakulteti Juridik dhe UP në vitet e fundit kanë krijuar mbështetje të qëndrueshme të pjesëmarrjes së studentëve në garat më prestigjioze për studentët e drejtësisë, e ku edhe rezultatet dhe përfaqësimi është i jashtëzakonshëm. UP përgëzon studentët, trajnerët e ekipit dhe fakultetin për suksesin e arritur.

## Pas Thaçit, edhe Rexhep Selimit i largohet një prej avokatëve më të rëndësishëm

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Një ndër avokatët më të rëndësishëm të Rexhep Selimit, David Young, është larguar nga ekipi mbrojtës. Lajmi është bërë me dije në një publikim në faqen zyrtare të Speciales. "Më 13 shkurt 2024 sekretari konfirmoi ndërprerjen e kontratës së z. Young si bashkavokat për z. Selimi", thuhet në njoftimin e Speciales.

Avokati kryesor i Selimit, Jeffrey Roberts, kishte dërguar

letër te trupi gjyques ku e kishte njoftuar për shkëputjen e kontratës me Young. Për këtë ka dhënë detaje gruaja e Selimit, deputetja Shqipe Selimi, e cila ka thënë se Young është liruar nga detyra për shkak të problemeve shëndetësore. "Squarim për publikun. E shkruaj këtë squarim në lidhje me lajmet e fundit që po qarkullojnë në media se njëri nga avokatët në ekipin e Rexhep Selimit është larguar nga ekipi. Një gjë e tillë

është e vërtetë, por nuk ka të bëjë asgjë me çështje financiare, por me çështje shëndetësore të avokatit David Young. Ekipi i Rexhep Selimit vazhdon punën si gjithmonë, të përkushtuar ndaj të drejtës dhe fitores. E falenderoj avokatin Young për punën e palodhshme në mbrojtje të Rexhës", ka shkruar në "Facebook" Shqipe Selimi. Edhe Gregory Kehoe, si avokati kryesor i Thaçit, është larguar



# **Sarrazin: Kosova dhe Serbia duhet ta çojnë përpara zbatimin e Ohrit**

I ngarkuari i Qeverisë së Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka theksuar se Kosova dhe Serbia duhet ta çojnë përpresa zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. Kjo, sipas tij, është vendimtare për të dyja vendet. “Më duket se nuk ka kuptim të mendosh shumë se çfarë do të vijë paskëtaj. Ne jemi për Ohrin dhe duam që të dyja palët ta çojnë përpresa zbatimin e Ohrit dhe mendoj se kjo është vendimtare. Unë shoh në të dyja palët se politika e brendshme do të bëhet një faktor i rëndësishëm”, ka deklaruar Sarrazin

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Në kuadër të Konferencës së Sigurisë në Munih, i ngarkuari i qeverisë gjermane për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka theksuar për DW se Kosova dhe Serbia duhet të shkojnë përpara në zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. "Së pari duhet thënë se dritarja nuk është mbyllur ende. Ne kemi të dërguarin e posaçëm të BE-së, Miroslav Lajçak, i cili punon. Ai ka një ajendë dhe do ta arrijë zbatimin dhe implementimin e Ohrit. Dhe qasja jonë është që ta mbështesim atë dhe të bëjmë gjithçka, që kjo dritare të shfrytëzohet, të cilën Miroslav Lajçak e plotëson tani. Ai është shumë aktiv dhe kjo është qasja jonë. Më duket se nuk ka kuptim të mendosh shumë se çfarë do të vijë paskëtaj. Ne jemi për Ohrin dhe duam që të dyja palët ta çojnë përpara zbatimin e Ohrit dhe mendoi se kjo është

vendimtare. Unë shoh në të dyja palët se politika e brendshme do të bëhet një faktor i rëndësishëm. Dua ta them në mënyrë eksplikite: e ardhmja e të gjithë rajonit është në BE dhe kjo duhet të qëndrojë nganjëherë mbi politikën e brendshme”, ka thënë Sarrazin. I pyetur se si Kurti ashtu edhe Vuçiqi ishin në Munih, dhe a pati ndonjë impuls për të cilin mund të thuhet se po ndodh diçka?, Sarrazin ka pohuar se Gjermania mbetet e angazhuar që të ketë përparim në dialog mes dy vendeve. “Jo diçka për cilën unë mund të flisja këtu. Por një gjë mund të dihet me siguri, se qeveria gjermane mbetet e angazhuar për të bërë gjithçka, në mënyrë që këtu së shpejti të ketë përparim”, ka thënë ai. Në Konferencën e Sigurisë në Munih kësaj radhe të binte në sy që në programin zyrtar nuk kishte asgjë për Ballkanin



Perëndimor. Sarrazin ka theksuar se ndodhemi në një fazë kur lufta në Ukrainë, çështja e rendit të ardhshëm botërор, zgjedhjet në ShBA dhe Trumpi, qëndrojnë në plan të parë. “Unë besoj se secili e di që ne ndodhemi në një fazë, kur lufta në Ukrainë, çështja e rendit të ardhshëm botërор, zgjedhjet në ShBA dhe Trumpi, duket se qëndrojnë në plan të parë njëherë përmnjëherë. Besoj se nuk duhet të harrojmë, se në të gjitha këto çështje aftësia strategjike e Evropës për ta zhvilluar pozitivisht Ballkanin

Perëndimor do të jetë vendimtare për pyetjen, nëse do të na marrin seriozisht në çështjet e tjera. Sigurisht që nga BE kërkohet ta furnizojë Ukrainën, por tema, së paku e dyta për nga rëndësia, është Ballkani Perëndimor. Nëse atje kapaciteti i BE-së nuk funksionon në mënyrë adekuate, si mund të na marrë seriozisht dikush shumë, shumë larg nesh, në konkurrencën globale për çështjet e mëdha botërore", ka deklaruar ai.

Manuel Sarrazin, ka theksuar se Ukraina ka bërë që Evropa të jetë e vendosur për ta dashur zgjerimin edhe me Ballkanin Perëndimor, të gjitha kryeqytetet, jo vetëm Berlini apo Brukseli, edhe të tjerët. "Kancelari dhe ministrja e Jashtme janë shumë të lidhura me zgjerimin e Ballkanit Perëndimor në biografinë dhe mendësinë e tyre. Ukraina dhe Ballkani Perëndimor për ne nuk përbëjnë kundërshti, por të dy kanë një rëndësi të jashtëzakonshme gjeostrategjike", është shprehur Sarrazin.

# **Presidenti i Austrisë shpreson që një zgjidhje e qëndrueshme dhe funksionale Kosovë - Serbi të gjendet shpejt**



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Presidenti i Austrisë, Alexander van der Bellen, ia ka dërguar një letër urimi presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, me rastin e 16-vjetorit të pavarësisë, nëpërmjet së cilës ia ka shprehur mbështetjen për rrugën drejt integrimit evropian.

Van der Bellen përmendi bashkëpunimin për rritjen e stabilitetit, ndërsa tha se shpresojnë që së shpejti të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Enderuar zonja presidentë, me rastin e Festës Kombëtare të Republikës së Kosovës kam kënaqësi të madhe t'ju përcjell urimet e mia më të nrohta. Austria dhe Kosova kanë marrëdhënie të shkëlqyera dypalëshe. Duke pasur parasysh shkëmbimet politike, ekonomike, shkencore dhe kulturore, nuk është çudi që ne shohim sot praninë e një

# Kurti: Me ShBA-në s'pajtohem për gjithçka, por raportet janë të mira



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se bashkëpunimi i Kosovës me Shtetet e Bashkuara është i mirë, por se kjo nuk do të thotë që dy vendet "pajtohen absolutisht për gjithçka". Kurti tha se neveria e tij duhet ta respektojë rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës, që e ndalon përdorimin e dinarit

serb, sepse me Kushtetutë dhe ligj e ka për detyrë. ShBA-ja është shprehur e shqetësuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar përdorimin e dinarit - valutë në të cilën komuniteti serb në Kosovë pranon pagesa të ndryshme nga Serbia që nga paslufta më 1999.

Ndihmësi i sekretarit amerikan

të Shtetit, James O'Brien, tha se Kosova duhet të tjerhiqet nga ky vendim që "e vë në pikëpyetje partneritetin me ShBA-në".

Ngjashëm insistoi edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, i cili tha se vendimi për dinarin i ka prekur tashmë raportet mes dy vendeve.

Kurti, megjithatë, këmbënguli

se "raportet janë shumë të mira" dhe se ai "i qëndron kësaj fjalë".

Teksa foli për gazetarët gjatë vënies së gurthemelit të një fabrike për prodhimin e dyerve dhe dritareve në Verbicë të Gjilanit, Kurti u pyet edhe nëse është ftuar nga zyrtarë të Bashkimit Evropian për ta takuar presidentin e Serbisë,

Aleksandar Vuçiç, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Ai tha se do të shkonte në takim nëse do të ftohej për nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit. "Unë këtë e bëj për BE-në, por e bëj edhe për shkak se duhet të kemi marrëdhënie normale me Serbinë. Sa për mua, marrëdhëni do të normalizoheshin qysh në vitin e kaluar, por nëse nuk është bërë në shkurtin dhe marsin e vitit 2023, e mund të bëhet në shkurtin e marsin e vitit 2024, pse jo", tha Kurti.

Marrëveshja në fjalë është arritur gojarisht vitin e kaluar dhe, mes të tjera, kërkon nga Kosova ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe nga Serbia ta njohë de facto Kosovën. Sipas Kurtit, është Vuçiç që refuzon ta nënshkruajë marrëveshjen, ndërsa vetë Vuçiç thotë se, fillimisht, duhet zbatuar ajo që është nënshkruar.

Për Asociacionin dy vendet janë pajtuar nga viti 2013, por autoritetet e Kosovës kanë refuzuar ta themelojnë nga frika se mund të ndikojë në funksionalitetin e brendshëm të shtetit.

## Hovenieri: ShBA-ja dhe populli i Kosovës kanë lidhje të forta

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka dekluaruar se lidhjet e forta dhe përkushtimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj popullit të Kosovës është që nga presidenti Clinton, Bush, Obama, Biden dhe presidenti Trump.

Hovenieri i bëri këto komente në

ceremoninë e organizuar pranë shtatores së ish-presidentit Clinton në Prishtinë, ku edhe u shënua Dita e Presidentit Amerikan.

Ambasadori Hovenier derisa tregoi se si u krijuar kjo festë, tha se ambasadat dhe konsullatat e Shteteve të Bashkuara në mbarë botën festojnë praninë amerikane dhe lidhjen e tyre me botën jashtë Shteteve të Bashkuara. "Jam krenar që bashkohem me homologët e mi anembanë botës dhe i bëj homazhe detyrës së presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe ta njoh lidhjen e fortë të ShBA-së me popullin e Kosovës siç mishërohet kaq qartë nga kjo statujë e presidentit

Clinton. Unë jam vërtet i nderuar, dhe në emër të Shteteve të Bashkuara, mund të them se jemi të gjithë kolektivisht të nderuar që presidentja Osmani dhe ekipi i saj kanë udhëhequr përpjekjet për të siguruar që sot, në Ditën e Presidentit, ne u bëjmë homazhe të gjithë presidentëve të ShBA-së dhe i kushtojmë një nderim të veçantë presidentit Clinton. Faleminderit presidentja Osmani që në këtë mënyrë e nderoni festën tonë. E vlerësojmë këtë. Tani besoj se kjo nismë, edhe pse është një fenomen global, është veçanërisht relevante dhe e veçantë këtu në Kosovë. Siç theksoi me të drejtë presidentja Osmani, përkushtimi i Shteteve të Bashkuara ndaj popullit të Kosovës i paraprin presidentit Clinton dhe vazhdon pas presidentit Clinton, dhe unë vetë mund t'ju tregoj për gjërat që unë e kam parë presidentin Bush, presidentin Obama, presidentin Biden dhe presidentin Trump, të bëjnë për Kosovën", ka thënë Hovenieri, raporton ksp.



## Gërvalla takon homologët nga Kroacia, Portugalia dhe Lihtenshtajni, i njofton për tendencat destabilizuese të Serbisë

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Në marginat e Konferencës së Sigurisë në Munih të Gjermanisë, ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës, Donika Gërvalla, ka zhvilluar disa takime.

Në njoftimin e bërë nga MPJD thuhet se Gërvalla ka takuar ministrin e Punëve të Jashtme

të Kroacisë, Gordan Grlic Radman, ministrin e Punëve të Jashtme të Portugalisë, Joao Gomes Cravinho, si dhe ministren e Punëve të Jashtme të Lihtenshtajnit, Dominique Hasler. "Gjatë këtyre takimeve ministria Gërvalla i njoftoi homologët e saj rreth proceseve nëpër të cilat po kalon Kosova, duke përfshirë

sigurinë dhe tendencat destabilizuese të Serbisë, të cilat e rezikojnë hapur sigurinë dhe stabilitetin jo vetëm në Ballkanin Perëndimor, por edhe më gjérë", bëhet me dije në njoftim. Më tej, në njoftim thuhet se "bashkëpunimi në fushën e ekonomisë dhe mbështetja për Kosovën në rrugën e saj drejt



anëtarësimit në mekanizma ndërkombëtarë ishte pjesë e rëndësishme e diskutimit të frytshëm bilateral me Kroacinë, Portugalinë dhe Lihtenshtajnin".

## Telekomi i Kosovës bën thirrje për veprime urgjente për parandalim të krimit finanziar

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Telekomi i Kosovës ka njoftuar se më 16.02.2024 ka pranuar aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, që lidhet me kontestin e dalë nga vendimi i arbitrazhit i viti 2016 i zhvilluar në mes të Telekomit të Kosovës dhe kompanisë Dardafon/Zmobile (me pronar Blerim Devoll).

"Ky aktvendim, i marrë nga gjykatësi Hasan Kryeziu, është tërështë antilogjor, i padrejtë, në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike, në kundërshtim të plotë me provat e pakontestueshme dhe, më keq, në kundërshtim të plotë me vendimin e Dhomës së Shkallës së Dytë pranë të njëjtës Gjykatë, i marrë më 30.11.2023, dhe një mosrespektim i plotë i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm", është thënë në njoftimin e Telekomit, duke bërë thirrje për veprime urgjente për parandalim të krimit finanziar. Më tej në njoftim theksohet se Dhoma e Shkallës së Dytë pranë Gjykatës Komerciale i ka kthyer tri herë në rigjykim vendimet e Dhomës së Shkallës së Parë për të njëtin rast si pasojë e shkeljes së dispozitave ligjore dhe shkeljes së të drejtave materiale të palës debitor (Telekomit të



Kosovës). "Vendimi i 30.11.2023, në paragrin e parafundit të faqes së 5-të, kërkon nga Dhoma e Shkallës së Parë që përrigjykim të angazhojë ndonjë institucion ose kompani të licencuar të auditimit, me qëllim që ta hartojë ekspertizën financiare e cila do t'i definjojë obligimet e sakta të palëve. Po ashtu, në paragrin e parafundit të faqes së 6-të të vendimit të Shkallës së Dytë, nga Shkalla e Parë kerkohet të veprojë në përputhje me Nenin 199 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Citim, Neni 199: Gjykata e çështjes e ka për

detyrë që, pasi t'i arrije aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, menjëherë ta caktojë seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, e cila duhet të mbahet më së voni tridhjetë (30) ditë pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, dhe t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj", thuhet në njoftimin e Telekomit. Më tutje theksohet se gjatë kohës që Telekomi i Kosovës po e priste ftesën përmbytjen e

seancës përgatitore dhe përzgjedhjen e institucionit që do ta bënte ekspertizën financiare, sipas direktivave të Dhomave të Shkallës së Dytë, siç kerkohet nga neni 199 i LPK-së, më 16.02.2024 e pranuan aktvendimin e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, i marrë në të njëjtën ditë dhe në mënyrë tërështë abuzive nga gjyqtari i çështjes, pa u mbajtur asnjë seancë ku palët do të mund t'i paraqitnin pretendimet dhe provat e tyre dhe pa e caktuar fare ekspertizën financiare siç kerkohet në vendimin e Shkallës së Dytë. "Nëpërmjet

këtij aktvendimi, lihet në fuqi urdhri përmbarimor, i lëshuar në vitin 2019, i cili e hap rrugën për bllokimin e llgarive bankare të Telekomit dhe grabitjen e shumës prej mbi 5.7 milionë euro të tjera", thuhet në njoftim.

Telekomi ka theksuar tutje se në ndërkohë, me të gjitha provat dhe faktet e paraqitura në gjykatë, është vërtetuar se Telekomi i Kosovës e ka paguar shumë mbi 40 milionë euro në emër të vendimit të Arbitrazhit, ndonëse obligimi nga vendimi i Arbitrazhit ishte përrreth 27 milionë euro. "Kështu, deri tanë Telekomi i Kosovës, në mënyrë të dhunshme, është detyruar të paguajë mbi 13 milionë euro më tepër. Sipas aktvendimit në fjalë, plaçkitja e shumës prej 5.7 milionë euro rezulton të jetë një pagesë e tepërt, mbi 19 milionë euro më e lartë se shuma e obliguar sipas vendimit të Arbitrazhit. Të gjitha këto pagesa të tepërt janë bërë si pasojë e vendimeve të gabuara të Gjykatave si dhe kthimeve të njëpasnjëshme në rigjykim të kësaj çështje; deri dhe në Gjykatën Kushtetuese. Ne jemi të bindur se ky aktvendim, përvëc që është i jashtëligjshëm, ka dhe elemente të qarta kriminale, nëpërmjet të cilave synohet t'i bëhet një dëm i pariparueshëm Telekomit të Kosovës", ka njoftuar Telekomi i Kosovës.

## O'Brien: Mali i Zi, partner i fuqishëm i NATO-s

**PODGORICË, 19 SHKURT** - Ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, tha se Mali i Zi është një "partner i fuqishëm i NATO-s" dhe shprehur bindjen se qeveria malazeze mund të nisë një integrim më të thellë evropian dhe transatlantik.

O'Brien u prit të hënën në Podgoricë nga kryeministri malazez Millojko Spajiq. Paraprakisht ai u takua edhe

me prokurorin e lartë dhe special të Malit të Zi. "Jam i bindur për përkushtimin e Malit të Zi në rrugën evropiane. Fakti që prokurorët po veprojnë me kapacetet të plotë është një arritje e madhe e qeverive të fundit. Institucionet e ndërtuara do të punojnë për të mirën e qytetarëve", tha O'Brien. Më 27 janar Kuvendi i Malit të Zi zgjodhi Millorad

Markoviqin prokuror të lartë të shtetit, pesë vjet pasi kjo pozitë u mbajt nga ushtrues dytre.

Komisioni Evropian e vlerësoi emërimin e tij si jetik përsundimin e ligjit.

Spajiq tha se në fokus të bisedës së tij me zyrtarin amerikan ishte ekonomia. Ai tha se pret që ekonomia amerikane të jetë shumë më e interesuar përmbytjen malazez.



## Ministrja Rizvanollit viziton ndërmarrjen KRU "Drini i Bardhë", kërkon angazhim në punë

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanollit, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe zëvendësministrin e Ekonomisë, Getoar Mjekut,

kanë vizituar ndërmarrjen KRU "Drini i Bardhë". "Menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujites nga KRU 'Drini i Bardhë' është esenciale për komunën e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës

dhe Junikut", ka thënë Rizvanollit. Ajo ka bërë me dije se me kryeshefin Bedri Haxhijaj dhe anëtarët e bordit të sapoemëruar kanë diskutuar mbi shërbimet dhe mënyrat

për t'i përmirësuar këto dhe performancën e ndërmarrjes. "Nga menaxhmenti kërkuan angazhim shështë dhe proaktivitet për t'i ndërmarrë hapat e duhur në këtë drejtim", ka thënë ministrja Rizvanollit.



## Osmani: Janë duke vazhduar diskutimet për planin e tranzacionit të zbatimit të rregullores së BQK-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se janë duke vazhduar diskutimet se cili do të jetë plan i tranzacionit të zbatimit të rregullores së re të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), e ku do të merren parasysh shqetësimet e të gjithëve.

Osmani ka thënë se nuk është e vërtetë që ka prishje të raporteve me ShBA-në për shkak të çështjes së dinarit. Ajo i bëri komentet për medie, pasi së bashku me ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier, mori pjesë në shënimin e Ditës së Presidentit amerikan, në një manifestim që u mbajt pranë statujës së ish-presidentit Bill Clinton në Prishtinë.

Osmani ka thënë se ShBA-ja dhe aleatët e tjerë nuk janë duke kërkuar që të mos respektohet Kushtetuta por, sipas saj, është duke kërkuar një plan tranzicioni

për zbatimin e rregullores së BQK-së. Ajo ka theksuar se si presidentë e vendit vazhdumisht i ka inkurajuar institucionet e vendit që bashkëpunimin ta kenë në maksimum me aleatët. "ShBA-ja dhe aleatët e tjerë nuk po kërkojnë ta mbajmë dinarin, të jemi të quartë. Nuk do të duhej të krijohej një përshtypje që ndokush po kërkon prej nesh që të mos ta respekojmë Kushtetutën, sepse nuk është e vërtetë. Pra kemi një mirëkuptim të plotë dhe, në fakt, qëllim të përbashkët me aleatët tanë, në veçanti me ShBA-në, që Kushtetuta janë të respektohet plotësisht. E tëra që është duke u diskutuar është një plan tranzicioni për zbatimin e rregullores së BQK-së. Rregullorja mbetet ajo që është, askush nuk po kërkon që rregullorja të ndryshojë, e cila bie nën domenin e BQK-së, po institucionet që e zbatojnë atë. Institucionet ligjzbatues sikurse edhe për çdo vendim tjetër



ndërtojnë plane të zbatimit, edhe në këtë rast ende janë duke vazhduar diskutimet se cili do të jetë plani i tranzacionit të zbatimit që do t'i marrë parasysh shqetësimet e të gjithëve", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se sikurse çdoherë

tjetër, bashkëpunimi me aleatët tanë asnjëherë nuk e çon Kosovën në rrugën e gabuar. "Kështu që si presidentë e vendit vazhdumisht i inkurajoj institucionet që bashkëpunimin ta kenë në maksimum, sepse sa herë veprojmë të bashkuar jemi shumë më të fortë,

dhe të njëjtën gjë e kërkoj edhe tani, dhe jam e bindur se jemi në rrugë të drejtë. Ky plan i tranzacionit të arrihet me pajtimin e të gjithëve dhe të jemi efektivë në tërsë, por edhe bashkë me aleatët tanë në zbatimin e Kushtetutës tonë në çdo cep të vendit", ka thënë Osmani.



## Hapet kompania më e re në vend 'Carvago' nga "Gjirafa"

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë e përrurimit të kompanisë më të re në vend "Carvago by Gjirafa", në të cilën ishte e pranishme edhe presidentja e vendit, Vjosa Osmani.

Kompania "Carvago" është produkt i partneritetit ndërmjet kompanisë së teknologjisë digitale, "Gjirafa" dhe kompanisë "Carvago Holding" nga Republika Çeke.

Ceremonia përrukses u zhvillua

në hapësirat e Parkut Teknologjik "Tech Park" në Bërnicë të Poshtme. E konsideruar si një ndër arritjet e radhës sa i përket fushës së teknologjisë dhe inovacionit, "Gjirafa" shquhet si një ndër kompanitë me rrjetin më të shpejtë në tregun e Kosovës dhe jashtë saj. "Suksesi i 'Gjirafës' është shembull i fuqisë transformuese të inovacionit, duke treguar se kompanitë vendore mund të konkurrojnë në tregun global", është shprehur kryeministri Kurti.

## Më pak gjermanë pëlqejnë pensionimin e parakohshëm

**BERLIN, 19 SHKURT** - Secilën herë e më shumë banorët e Gjermanisë janë duke punuar deri në moshën 67-vjeçare, kanë treguar disa të dhëna qeveritare.

Mosha standarde e pensionimit për ata që kanë lindur pas vitit 1964 është 67-vjeçare.

Pensionimi i parakohshëm mund të zbatohet prej moshës 63-vjeçare me zgjedhje përfitimeve.

Të dhënat zyrtare tregojnë se numri i personave në grupmoshat 63 dhe 67 vjeç, që janë ende në punë, është rritur ndjeshëm prej 1.31 milion në 1.67 milion vitin e kaluar.

Më 2022, 1.52 milion njerëz në këtë grup-moshë kanë qenë ende të pensionuar.

Këto të dhëna janë bërë publike pas debatit përfitimeve.


pensionet, të ngritur prej partisë së krahut të majtë, Linke.

Debati është aktualizuar për shkak të rritjes së numrit të njerëzve që janë në kohën e pensionimit dhe mungesës së punëtorëve, në anën tjetër.

Disa sindikata të punëtorëve dhe politikanë të krahut të majtë janë duke e kundërshtuar rritjen e moshës së pensionimit në 70 vjeç.



# Pse Bob Marley është ikonë e të drejtave të njeriut?



Nga: Silke WÜNSCH

Kur Bob Marley doli në qershori të 1980-ës për të kënduar në skenën e Sallës së Sportit në Këln, muzikanti nga Xhamajka i kishte të dukshme shenjat e sëmundjes. Por, shkëlqimi i tij i bëri për vete tetë mijë spektatorët, sidomos kur këndoi këngën Këngën e shpagimit [Redemption Song]: krejt i vetëm në konin ndriçues të një projektori drite, rrëthuar nga retë e tymit të krijuara prej qindra cigareve me hashash që kalonin nëpër publik nga njëra dorë në tjetër.

Një vit më vonë Marley vdiq – më 11 maj 1981, nga sëmundja e kancerit. Ishte 36 vjeç. Por, mesazhet e tij politike dhe shpirtërore janë edhe sot gjallë dhe do të vazhdojnë të jetojnë në këngët e tij.

Bob Marley në botë e lansoi muzikën rege dhe mesazhet e saj në mënyrë aq bindëse, saqë UNESCO-ja e ka futur këtë lloj muzike në trashëgiminë shpirtërore të botës dhe rege sot luhet kudo në botë. Filmi biografik Një dashuri [One Love], do të ngre një përmendore tjetër për Bob Marleyn.

Në moshën 22-vjeçare, Bob Marley zbuloi fenë rastafiane. Kjo fe është krijuar rrëth 100 vjet më parë. Si moment krijimi shënohet dita kur Haile Selassie I u kurorëzua perandor i Etiopisë më 2 nëntor 1930. Pak vite më parë, aktivisti xhamajkian Marcus

Garvey kishte profetizuar kurorëzimin në Afrikë, të një mbreti të fuqishëm me ngjyrë, i cili do të sillte çlirimin nga prangat për të gjithë njerëzit me ngjyrë. Emri original i Selassies ka qenë Ras Tafari Makkonen. "Ras" do të thotë "Kont" në gjuhën amhare, në gjuhën që flitet në Etiopi. Besimtarët e fesë rastafiane shihnin tek ai ringjalljen e Krishtit dhe atë e trajtonin sikur të ishte zoti i gjallë mbi Tokë. Shumë pjesë të besimit në fenë rastafari i referohen Biblës, sidomos Testamentit të Vjetër.

Besimtarët e fesë rastafiane besojnë në rikthimin shpirtëror në Afrikë, në tokën e premtuar, në Etiopi. Xhamajkianët me ngjyrë janë pasardhës të sklevërvë që u sollën me detyrim nga Afrika për në Amerikë dhe në Karaïbe.

Besimtarët e kësaj feje duan që me ndihmën e besimit të arrijnë një ndryshim kulturor, për të ndryshuar kulturën e krijuar nga skllavërimi i të parëve të tyre. Për të krijuar një jetë sa më të natyrshme dhe afër natyrës, me parimet e dashurisë dhe të paqes, të drejtësisë, unititet dhe drejtësisë, si dhe luftë kundër Babilonit – një sinonim ky për "botën perëndimore" që ka sjell kaq shumë fatkeqësi për popullin afrikan. Babiloni është sinonim edhe për Xhamajkën, vendin ku u sollën si sklevër të parët e tyre. Besimtarët e rastafianë janë kundër çdo lloj forme të nënshtimit politik, kulturor dhe

fetar të njeriut. Kështu, kjo fe është lëvizje mbarëbotërore me ithtarë te njerëzit me ngjyra të ndryshme lëkure. Sot, numri i tyre – në gjithë botën – vlerësohet të jetë 700 mijë deri në një milionë. Duke mbajtur flokë me rraca [dreadlocks] disa besimtarë duan të distancohen me qëllim nga shtresa e lartë e shoqërisë. Rrënjet historike të stilit të tillë të flokëve e kanë originën tek luftëtarët e lirisë të mau-mauëve që luftonin në Keni kundër Britanisë kolonialiste. Besimtarët e fesë rastafiane identifikohen me ta. Pirja e marijuanës, e lidhur me ta, shërbën më shumë për zgjerimin e vetëdijes sesa për të trazuar mendjen dhe nuk është doemos pjesë e fesë rastafiane.

Bob Marley, që vlerësohet të jetë ylli i parë botëror që vjen nga një vend në zhvillim, e bëri të njohur për gjithë botën edhe muzikën rege edhe besimin e rastafarianëve. Kjo muzikë ka lindur në vitet 1960 në Xhamajka, në një kohë kur trazirat sociale dhe gangsterët i bënin të pasigurta rrugët e vendit. DJ-të, që bënin muzikë në rrugë me kastofonat e tyre (diskotekat mobile), e zhvilluan këtë lloj tingulli duke marrë ndikim nga llojet e njohur më mirë – si mento, ska, soul dhe xhaz. Bob Marley ishte pjesëmarrës i rëndësishëm në këto zhvillime.

Ritmi i lëshuar, por edhe shtytës, përshtatet më së miri për përhapjen e mesazheve pozitive

të paqes dhe të dashurisë. Tekstet e Bob Marleyt përdorin shumë retorika fetare, megjithatë ato janë tokësore dhe tregojnë për problemet e një pakice të diskriminuar, për getot, skllavërinë dhe padrejtësitë. Besimi rastafarian shoqëron si një emëruesh të përbashkët këngët e Marleyt.

Cohu, rezisto [Get Up, Stand Up] është krijuar pasi Bob Marley shkoi në Haiti ku, me sa duket, u shokua nga varfëria që sundonte atje nën diktaturën e Duvalierit (1957-1986). Teksti u bën thirje njerëzve të luftojnë për të drejtat e tyre dhe të mos dorëzohen. Kënga inkurajon njerëzit të kenë besim te gjyki i tyre, ndërsa shihet si himni jozyrtar i organizatës Amnesty International.

Kënga Eksodi [Exodus] merret me kthimin në Afrikë të besimit rastafarian. Në tekst thuhet: "Ajeni të kënaqur me jetën që bën? E dimë ku po shkojmë, e dimë prej nga vijmë, po ikim nga Babilonia, po shkojmë në vendin e baballarëve ... Ekzili është lëvizja e populli të Jahut (Zotit)".

Në këngën Zimbabveja [Zimbabwe], Bob Marley nxit afrikanët që të çlirojnë Zimbabvenë që – duke qenë koloni britanike – mban emrin Rodezia. Në festimet për pavarësimin e Zimbabvesë, Marley e interpretoi këtë këngë në kohë reale. Ajo u kthye në himnin jozyrtar kombëtar të vendit. "Pa grua, pa ulërima" [No

Woman, No Cry] do të kujtonte njeriu fillimisht se thotë ky titull. Por, Bob Marley dante të thoshte diçka tjetër, diçka ngushëlluese, sepse në gjuhën e banorëve të Trençtaunit, "No Woman, No Cry" do të thotë: "Jo, grua, mos qaj"! Trençtouni është getoja e kryeqytetit xhamajkian, Kingston – lagja ku u rrit Bob Marley. Kënga pasqyron jetën e atjeshe të karakterizuar nga varfëria dhe bandat e forta familjare që ndihmojnë njëra-tjetrën. Kënga është kompozuar kur Marley ishte ulur në oborr dhe dëgjonte se si qante një grua e lagjes.

Kënga e shpagimit është gjurma që ka lënë pas Marley. Ka shumë incizime të saj, por në fakt ai dante të kishte vetëm një version me zë të pastër dhe kitarë, duke lënë mënjanë instrumentet e tjera, në mënyrë që të rritet intensiteti i këngës. Në këtë këngë Marley citon profetin e fesë rastafiane, Marcus Garvey, i cili në vitin 1937 pati thënë në një fjalim mbajtur në radio: "Emancipjeni veten nga skllavëria mentale; askush tjetër nuk mund t'ua çlrojë mendjen". Skllavëria e të parëve duhet zhdukur nga kokat e njerëzve; vetëm kur e ka shpirtin të lirë, njeriu është vërtet i lirë. Këto mendime dhe duke e ditur se do të vdiste pas pak kohësh, e frymëzuan Bob Marley të kompozonte Këngën e shpagimit, një këngë me të cilën ai jep edhe sot shpresë për shumë njerëz në botë. /DW/

# OpenAI tani krijon video të rrreme. Dridhen Hollywood the politikanët



OpenAI, kompania kaliforniane që mahnitit botën me ChatGpt, i ka lënë sërisht të gjithë pa fjalë me Sora-n, inteligjenca artificiale e aftë për të gjeneruar video realiste duke nisur vetëm nga teksti.

Ashtu si ChatGpt u trajnua për miliarda shkrime, Sora u trajnua në një arkiv të madh videosh. Bazuar në atë që ka mësuar, Sora mund t'i transformojë udhëzimet e përdoruesve – të ashtuquajturat “prompts” – në imazhe lëvizëse.

Rezultati është magjik. Në një nga videot e publikuara nga OpenAI, një grua ecën në një rrugë në Tokio. Të gjitha komandat që i janë dhënë inteligencës artificiale janë respektuar. “Gruaja ka veshur syze dielli, xhaketë, fustan të kuq dhe çizme të zeza.” U tha, u bë. “Njerëz të tjerë po lëvizin pas saj.” U tha, u bë. “Afsalti është i lagur dhe reflekton dritat e neonit”. E bëri edhe këtë. Drejtimi i improvizuar i AI është gjithashtu mbresëlënës. Niset nga një tërësi që tregon kontekstin urban.

Pastaj kalohet në një plan të parë të gruas. Në një minutë – maksimumi që mund të realizohet tani për tani me Sora – vetëm dy gjëra e tradhëtojnë natyrën artificiale të imazheve: një simbol i vogël OpenAI – “prova” që përbajtja vjen nga një inteligjenca artificiale – dhe hapat ndonjëherë të pasigurt të “gruas me të kuqe”. OpenAI ka shfrytëzuar gjithashtu Italinë për të nisur krijimin e vet. Sora – që do të thotë “qiell” në japonisht – mund të krijojë një qytet buzë detit, i frysëzuar nga Amalfi, i kapur nga një dron. Ose një qen që ecën nëpër shtëpitë e Buranos.

Por janë thjesht demonstrime. Sora, në fakt, nuk mund të



provohet. Dhe ne nuk e dimë nëse, pasi të hapet për publikun, ajo do t'i përgjigjet në një mënyrë po aq të habitshme kërkuese të përdoruesve. Por kaq mjafton: OpenAI sapo ka përfunduar një marrëveshje që vlerëson kompaninë e San Franciskos në 80 miliardë dollarë, duke trefishuar vlerësimin e saj në 10 muaj. New York Times shkruan: kompania, e cila ka Microsoft në mesin e financuesve, do të shesë aksionet e veta në një ofertë

publike të udhëhequr nga kompania e kapitalit Thrive Capital. OpenAI aktualisht po vlerëson çdo trezik të kësaj teknologji. Do të ketë punë për të bërë. Nëse përdoret gabimisht, një mjet si Sora mund të rrisë në mënyrë dramatike deep fakes, ato video në të cilat algoritmet e bëjnë një individ – shpesh të famshëm ose politikan – të thotë (ose të bëjë) gjëra që nuk i kanë thënë apo bérë kurrë. Nuk mjafton prania e

filtrave apo censurës, të cilat duhet të parandalojnë gjenerimin e përbajtjeve të dhunshme, ofenduese dhe të turpshme. Ylli i popit Taylor Swift di diçka për këtë, pasi së fundmi u zhvesh nga inteligjenca artificiale e Microsoft, pavarësisht masave të sigurisë të

formimi që Sora do mund të nxiste nëse dikush do të gjente një mënyrë për ta përdorur atë për të klonuar Joe Biden, Donald Trump ose çdo person tjeter që kandidon për Shtëpinë e Bardhë, apo një vend në Parlamentin Evropian në 2024. Sora shqetëson edhe Hollywood-



miratuara nga kompania. Është e lehtë të imagjinohet keqin-



in dhe në përgjithësi ata që e fitojnë bukën me video të vërteta. “Ju lutem, mos më ktheni në një person të pastrehë”, i shkroi me ironi MrBeast, YouTuber-i më i ndjekur dhe më i famshëm në botë, Sam Altmanit, CEO i OpenAI. Por ka pak për të qeshur. Një studim i fundit nga Universiteti Carnegie Mellon në Pittsburgh theksoi se për të prodhuar një imazh, inteligjenca artificiale përdor energjinë e nevojshme për të karikuar një smartphone. Sa do t’ju duhet për një video prej disa sekondash? Pastaj është çështja e të drejtës së autorit. Çfarë imazhesh “studioi” Sora? OpenAI pretendon se ka përdorur video publike pa të drejtë autori. Por në të kaluarën kompania është përballur me disa padi – njëra prej tyre nga New York Times – për përdorimin e të dhënavë pa leje. / TruthHub – Bota.al



## Sejdiu, trajner i ri i Drenicës

**SKENDERAJ, 19 SHKURT** - Trajneri i mirënjojur kosovar, Gani Sejdiu është prezantuar nga skuadra e Drenicës. Tekniku mitrovicas do t'i prije skuadrës kuqezi në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. "Pas

ndërprerjes së bashkëpunimit me trajnerin Bashkim Idrizi, Bordi i KF Drenica, kanë vendosur unanimisht për ta emëruar kryetrajner të skuadrës, Gani Sejdiu. Ish-trajneri i Renoves në Maqedoni,

pastaj shumë skuadrave kosovare si Trepça '89, Feronikeli, Besa, Ballkani, Vëllaznimi e Phoenix, Gani Sejdiu ka arritur marrëveshje për 18 muaj me klubin, gjithmonë duke u bazuar në

ecurinë e klubit. Sejdiu është emër i njohur në futbollin kosovar pasi ka qenë kampion i Kosovës, fitues i Kupës së Kosovës, fitues i Superkupës së Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Drenicës.



## Basketbollistët e Kosovës po stërviten intensivisht për ndeshjen ndaj Irlandës

"Epoka e re"

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Basketbollistët e Kosovës janë duke u stërvitut intensivisht para ndeshjes ndaj Irlandës. Stërvitet jetë po mbahen dy herë në ditë, në mënyrë që të janë sa më të gatshëm për duelin e së enjtes, që është sfida e vetme në shtëpi për vitin 2024 si vendas. Atmosfera në kampin e Kosovës është mjaft e mirë, derisa nga lista e gjërë ka disa mungesa. Erjon Kastrati dhe Domenic Artis nuk do t'ë jenë për shkak të lëndimeve, derisa gjendja e Lis Shoshit do t'ë vlerësohet deri në fund. Jan Palokaj nuk do t'ë jetë pjesë e këtij grumbullimi për shkak të dokumentacionit. Kosova është në grup me Zvicrën, Irlandën dhe Azerbajxhanin. Sfidën e parë Dardanët e kanë më 22 shkurt ndaj Irlandës në Prishtinë, derisa sfidën e dytë ndaj Azerbajxhanit më 25 shkurt në udhëtim. Raundi i parë parakualifikues i Kupës së Botës të Basketbollit FIBA 2027 do t'ë luhet në tre ditare më 19-27 shkurt 2024, 18-26 nëntor 2024 dhe 17-25 shkurt 2025, nga një ndeshje në shtëpi dhe jashtë. Të tre fituesit e

grupeve së bashku me skuadrën e renditur më të mirë në vendin e dytë do t'ë kalojnë në raundin e dytë parakualifikues të Kupës së Botës 2027 të FIBA-s, i cili do t'ë luhet në verën e vitit 2025. Kosova po stërvitet nga ora 11:00-12:30 dhe 18:00-19:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë.

**Sot dalin në shitje biletat e ndeshjes Kosovë-Irlandë**

FBK-ja ka njoftuar se biletat për ndeshjen ndaj Irlandës do t'ë fillojnë të shitën nga dita e martë. Çmimi është 4 euro dhe dy euro nga çdo biletë e shitur do t'ë shkojnë për fëmijët e SOS Fshat. Kështu tifozët kanë mundësi të ndihmojnë basketbollistët e Kosovës me përkrahjen e tyre dhe fëmijët e SOS Fshat. Lojtarët e Kosovës kanë nevojë më shumë se

**TE SHESHI ZAHIR PAJAZITI**

E martë: 11:00-20:00  
E mërkurë: 11:00-20:00  
E enjte: 11:00-19:00



përkrahjen për të nisur kampjanën me fitore. Sfida ndaj Irlandës zhvillohet më 22 shkurt nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë

dhe Sportit në Prishtinë dhe është e vlefshme për Rrethin e Parë Parakualifikues për Kupën e Botës 2027. "Dardanët" janë në grup

edhe me Zvicrën dhe Azerbajxhanin. Takimi ndaj Azerbajxhanit zhvillohet më 25 shkurt në Baku.

## Ardian Limani, 'Ylli i javës' në Superligë



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsorë i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i Javës". Ky çmim për javën e 20-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistik të FC Prishtina, Ardian Limani. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Muhamet Sylejmani, Naim Kodraliu dhe Lulzim Rrmoku. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 20-të t'i takojë

Ardian Limanit, lojtar i FC Prishtina, pasi gjatë tërë ndeshjes ishte në nivel të lartë në mbrojtje, por ndihmojë bashkëlojtarët edhe në ofensivë si dhe shënoi një supergol në barazimin si mysafirë kundër Gjilanit (1-1). Çmimin "Ylli i Javës" për futbollistik e FC Prishtina, Ardian Limani e ndau Florian Ukëimeraj, dizajner grafik në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim futbollisti i bardhekaltërve u shpreh i lumtur për vlerësimin. "Përmua

është një kënaqësi e madhe ky çmim, duke e ditur që sapo i jam bashkuar ekipit më të trofeshëm në historinë e futbollit kosovar. Ndihem i vlerësuar dhe ky çmim më jep motiv shtesë që në vazhdim të ndihmoj edhe më shumë skuadrën time. Një falënderim të gjithë bashkëlojtarëve dhe shtabit teknik për bashkëpunimin në ndeshje dhe përfaktin që më kanë pritur mirë në kryeqytet", ka theksuar Limani përfaqen zyrtare të FFK-së.

## Kosova merr pjesë në turneun "Turkish Women's Cup" në Alanya

Prishtinë, 19 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave edhe sivjet do t'ë marrë pjesë në turneun prestigjioz "Turkish Women's Cup" në Alanya të

Turqisë, në periudhën prej 21 deri më 27 shkurt. Në këtë turne, "Dardanet" do t'ë ballafaqohen me Hong Kongun, Estoninë dhe Indinë. Përgjedhësja Anneli Andersen përfshin këtë turne ka ftuar

24 futbolliste. Pas suksesit në Ligën C të Ligës së Kombeve, ku Kosova fitoi grupin në konkurrencë me Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut, ky turne do t'ë jetë mundësi e mirë për ta

mabajt formën e mirë dhe përfshirë vazhduar ritjen e performancës. "Dardanet" sot (e martë) grumbullohen në Alanya, derisa ndeshjen e parë e zhvillojnë pasnesë kundër Hong Kongut.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i pozitës:** Auditor i Brendshëm – I pozitë

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek:** Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emëritimit:** me afat të pacaktuar (periudha provuese: 3 muaj)

**Detyrat dhe përgjegjësitet:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen auditime, përsfihë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgatit draft-raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare me të audituarin;
- Harton raportin final me rekomandimet adekuante, finalizon dosjen e auditimit dhe dorëzon atë për arkivim;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e njësive organizative;
- Ofron këshilla dhe udhëzime për çështje të auditimit të brendshëm brenda kompanisë sipas nevojës;
- Koordinon punët me pjesët e tjera të njësive dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës;
- Vlerëson sistemet e kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti se a janë adekuante;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm;

**Shkathësi e kërkuar:** (afësitet e shkathësi që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha përkatëse; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri dhe përvjojë në fushën e auditimeve (përvjojë pune në auditimin e ndërmarrjeve publike dhe private do të jetë përparesi);
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme, me theks të veçantë Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe ligjive tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike;
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik, lëshuar nga Ministria e Financave ose të jetë i certifikuar për Auditor të Brendshëm në sektorin publik dhe privat nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar ose vendor;
- Njohuri me aftesi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathësi humtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvaja e punës:** (kualifikimet dhe përvaja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare në Fakultetin Ekonomik, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike apo fusha të tjera relevante;
- Tri (3) vite përvjojë pune profesionale në fushën përkatëse;

**Konkursi është publikuar më datë 20 shkurt 2024 dhe mbyllt më datë 05 mars 2024.**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (Vërtetimi ose kontrata e punës);
- Dy rekomadime (nëse keni);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tillë);
- Dokumentin e identifikimit–letërmjofte i fotokopjuar;
- Certifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

### MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërrë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërrë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

### KUSHTET E PJESEMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

### VËREJTJE:

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit. Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurense u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A kuranu izjavljuje:

## KONKURS

**Naslov pozicije:** Interni revizor – I pozicija

**Institucija:** Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

**Naslov supervizora:** Izveštaj: Službenik interne revizije

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Termin imenovanja:** neodređeno vreme (probni period: 3 meseca)

**Dužnosti i odgovornosti :** (kratak opis glavnih zadataka)

- U saradnji sa supervizorom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za vršenje relevantnih revizija i usluga;
- Sprovodi reviziju, uključujući dolazne intervjuje sa revizorski sektor, intervjuje osoblje, prima i analizira relevantnu dokumentaciju i beleži zaključke;
- Priprema nacrt izveštaja, razgovara sa supervizorom i obavlja završni intervju sa revizorima;
- Izrađuje konačni izveštaj sa adekvatnim preporukama, finalizuje revizorski dosije i podnosi ga na arhiviranje;
- Prati sprovođenje preporuka organizacionih jedinica;
- Pruža savete i smernice o pitanjima interne revizije unutar kompanije po potrebi;
- Koordinira rad sa drugim delovima jedinica i komunicira sa spoljnim vlastima po potrebi;
- Procenjuje sisteme unutrašnje kontrole koje je osmislio rukovodstvo ako su adekvatni;
- Za svoj rad odgovara službeniku interne revizije;

**Potrebne su veštine :** (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlično profesionalno znanje iz relevantne oblasti; Poželjno znanje engleskog jezika;
- Znanje i iskustvo iz oblasti revizije (radno iskustvo u reviziji javnih i privatnih preduzeća biće u prvom planu);
- Poznavanje važećih zakona i propisa, sa posebnim naglaskom na Zakon o javnim preduzećima i druge zakone koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Da budu sertifikovani u internoj reviziji u javnom sektoru, koju izdaje Ministarstvo finansija ili da budu sertifikovani za interne revizore u javnom i privatnom sektoru od strane bilo koje relevantne međunarodne ili lokalne institucije;
- Poznavanje dobrih veština rada na računaru pomoću aplita programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Interneta;
- Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

**Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo:** (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma Ekonomskog fakulteta, prava, državne uprave, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti;
- Tri (3) godine profesionalnog iskustva u relevantnoj oblasti;

**Konkurs je objavljen 20 februara 2024 godine, a zatvara se 05 marta 2024 godine.**

**Prijava:** Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

- Dokaz o školskim kvalifikacijama;
- Dokaz o radnom iskustvu (dokaz o zaposlenju ili ugovoru);
- Dve (ako imate) preporuke;
- Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (ako takvi postoje);
- Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
- Potvrde od suda da niste pod istragom.

### REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formulari se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštum: Prijava kompletana sa dokumentima može se podneti i poštum na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

### USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadatka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednakne mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

### UPOZORENJE:

**PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.**

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljanja. Za više informacija možete kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "KASHI" Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811318642 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "KASHI" D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811318642 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "KASHI" L.L.C, has come to the decision to quit its business: 811318642 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Ardit Sopi shpall të pavlefshme dëftesat e Q.K. "11 Marsi", Prizren.
- Sejdije Haruni shpall të pavlefshme diplomën e SHME "Ymer Prizreni", Prizren.
- Adem Hasani shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Shefket Rashlanin nga Istogu – Prishtinë, shpall të pavlefshme dëftesën e viti –I-, dhe –II-, të shkollë së mesme "Shtjefën Gjeqovi", Prishtinë.
- Venera Berila shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" Prishtinë.
- Ramadan Terpuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Nexhmedin Nixha".
- Albias Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Nexhmedin Nixha".
- Belinda Begiqi shpall të humbur Diplomën e Bachelorit të Kolegjit "Fama" drejtimi Psikologji.
- Fajtona Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Hysni Zajmi".
- Rexhep Ternava shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë "Ali Sokoli" ish shkolla e mesme "9 Maji".
- Egzon Osmani shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 dhe 12 shkolla e mesme e lartë "Arkitekt Sinani".
- Art Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të shkollës "Hajdar Dushi".
- Muhamer Bujari shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Xhylnaze Cena shpall te pavlefshme dëftesat e kl BI - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.
- Halid Asllani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "28 Nentori" Brodosan Dragash.
- Halid Asllani shpall te pavlefshme dëftesën e vitit I Q.K. "11 Marsi" Prizren.



**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA  
1992

